



PROGRAMI - III

PROMOVIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

RRETH 7ARTE

7Arte u krijua në maj 2006 nga një grup artistësh vendas në qytetin e Mitrovicës.

Me një përvojë 18 vjeçare, ajo luan rolin e një qendre alternative kulturore duke përdorur aktivitete kulturore multidisiplinare të tilla si: punëtori audio-vizuale, festivale muzikore, shfaqje filmash në ambient të hapur, arte në rrugë, netë me poezi, programe shkëmbimi e edukimi dhe aktivitete mjedisore.

7Arte është e vendosur në qytetin industrial të Mitrovicës, ku gërshetohet një diversitet i pasur etnik e kulturor. Duke qenë zonë e pasur me minerale dhe me një pozitë të veçantë gjeo-strategjike ku dhe mbarojnë malet e Kopaonikut, e takohen tre lumenj, e kanë bërë këtë qytet të dëshiruar ndër shekuj, nga civilizime të ndryshme. 7Arte është e vendosur në një qytet që ka një larmi të pasur kulturore dhe fatkeqësisht ka dy komuna të ndara në baza etnike. 7Arte është e vendosur në një ndërtesë mu në qendër të qytetit, e cila ka një stil brutal arkitekture, që është ndërtuar për bankën e njohur si “Bankos”, gjatë modernizimit të qytetit të Mitrovicës në mes të shekullit XX. Që nga viti 2011, 7Arte funksionon në katin e fundit të kësaj ndërtese, e cila ka një tarracë me një pamje të veçantë të qendrës së qytetit dhe një hapësirë prej 120 metrash, ku organizohen shumica e aktiviteteve kulturore.





Qëllimi kryesor i 7Arte është: Mbështetja e artistëve kosovarë; promovimi dhe zhvillimi i një kulture të përbashkët evropiane duke aplikuar artin dhe kulturën si një forcë shtytëse drejt krijimit të një rajoni paqësor, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Qëllimet tona strategjike përqendrohen në tri programe:

- 1. Ruajtja dhe promovimi i vlerave artistike-kulturore**
- 2. Fuqizimi i të rinjve dhe edukimit joformal; dhe**
- 3. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit përmes kulturës dhe artit**

7Arte përfshinë dhe inkurajon gratë të jenë aktive në iniciativa dhe programe të ndryshme, me fokus në fushën e industrisë kreative dhe trashëgimisë kulturore; një organizatë që përfshinë komponentën mjedisore, e përpiket për rijetëzimin e hapësirave të braktisura dhe të avokoj për politika gjithëpërfshirëse kulturore në nivelin lokal.



Zhvillimi i komunitetit dhe rrjetëzime

- Rreth 50 vullnetarë të përfshirë gjatë vitit
- Grupet e marginalizuara pjesë e aktiviteteve të programit
- Angazhimi i të rinjve si vullnetar gjatë aktiviteteve të Green Fest dhe më shumë
- Delegimi i të rinjve në programe edukative jashtë Kosovës.
- Krijimi i partneriteteve dhe përfshirja në rrjete të organizatave mjedisore brenda dhe jashtë Kosovës



Hulumtim dhe publikime

- **“Gjendja mjedisore në Mitrovicë”** – Gresa Ferri dhe Damir Gashi, 2023
- **“Gjendja e ujërave ne Mitrovicë”** – Egzona Shala, 2023
- **“Kopshtet urbane dhe kulmet e gjelbra në Mitrovicë”** – Fjollë Caka, 2024
- **Environmental Protection Toolkit** – Gresa Ferri, 2023
- **Si të krijojmë një fushatë të suksesshme digjitale; Doracaku i aktivizmit digjital** – Përpiluar nga YEE; Përkthyer nga 7Arte, 2022



Programe edukative

- Fuqizimi i 12 grupeve të gjelbra në shkolla fillore;
- Punëtori me tematika mjedisore;
- 7Arte Academy - përmes edukimit artistik dhe mjedisor.

Aksione mjedisore

- Mbjellja e 1007 pemëve në vitin 2023.
- Realizimi i një kopshti urban, sipas punëtorisë së arkitekturës
- Eko-kampet dhe intervenimet në hapësira publike.
- Përkrahja e nismave lokale si "Vullnetarët për Atdhe të Pastër" dhe "Ambientalistët e Mitrovicës."



Kampanja avokuese

- Kampanja vetedijësuese me Youth and Environment Europe (YEE).
- Realizimi i videove avokuese mbi gjendjen e lumenjve.
- Promovimi i ngjarjeve të suksesshme të ambientalistëve të rinj
- Takime me institucione dhe shoqëri civile.



Stil jete dhe mirëqenie

- Hiking, aksione mjedisore, joga, pilates, ciklizëm, boccia, etj.
- Dhënia e 12 çmimeve në kategoritë private dhe institucionale për kopshtet më të mira.

Green Fest

- Shfaqja e mbi 50 filmave mjedisor në hapësira publike;
- Realizimi i netëve poetike në natyrë;
- Green Talks;
- Programi edukativ "Green Kids" për të rritur vetëdijen mjedisore tek të rinjtë;
- Netë muzikore;
- Ekspozita me tematika mjedisore;
- Murale



Aspekti Ambiental:

7Arte ka qenë aktivisht e përfshirë në veprimtari të drejtpërdrejta për mbrojtjen e mjedisit.

Me programe edukative dhe punëtori të fokusuara në çështjet mjedisore, 7Arte bën përpjekje të ngrisë ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike dhe praktikën që mbështesin qëndrueshmërinë.

Green Fest si dhe aktivitetet e tjera të organizuara nga 7Arte promovojnë praktika miqësore, duke vënë në pah rëndësinë e kujdesit ndaj mjedisit.

Aspekti Social:

7Arte punon me grupe të ndryshme të komunitetit duke qenë gjithëpërfshirës për projektet mjedisore .

Duke integruar aktivitete stili jetese dhe sportive në programet e tyre, 7Arte nxit një stil jetese të shëndetshëm dhe aktive, që ka përfitime sociale.

Me vizita studimore dhe ngjarje bashkëpunuese, 7Arte forcon lidhjet komunitare dhe inkurajon veprimin kolektiv në çështjet sociale dhe mjedisore.

Aspekti i Qeverisjes:

Përpjekjet e 7Arte për avokim synojnë të ndikojnë në politikën lokale, në veçanti në fushat që lidhen me qeverisjen mjedisore.

Duke themeluar e punuar me klubet e gjelbra brenda shkollave fillore dhe duke ofruar aktivitete edukative, 7Arte kontribuon në ndërtimin e një baze të diturive për qeverisjen e ardhshme.

Me publikim të hulumtimeve dhe materialeve informuese, 7Arte promovon transparencën dhe informon publikun dhe krijuesit e politikave për çështjet mjedisore.






Së fundmi u lansua projekti ynë më i ri "**Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore në Kosovë**" (EECSOK)".

Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i organizatave partnere përmes rritjes së kapaciteteve të tyre për të adresuar sfidat në fushat përkatëse mjedisore, me synimin për të ndikuar në ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në mjedis. Derisa, 7Arte do të fokusohet në ngritjen e ndërgjegjësimit, avokimit dhe trajtimit të temave që merren me çeshtjen e ujërave/lumenjve në Mitrovicë dhe rrethinë. Njëherit, përmes këtij projekti do të fuqizohet festivali Mitrovica Green Fest, i cili gjatë vitit 2024 do të trajtoj temën "Jeta në ujë" sipas SDG 14. Krahas, kësaj pritet të zhvillohen edhe punëtori e programe edukative në kuadër të Akademisë 7Arte.

Projekti mbështetet nga **Embassy of Sweden in Prishtina**.

RRJETËZIMET



EFFE - EUROPE FOR FESTIVALS FESTIVALS FOR EUROPE

YEE - YOUTH ENVIRONMENT EUROPE

LOCAF - LOCAL CLIMATE ACTION FORUM IN KOSOVO

TEH - TRANS EUROPE HALLES

ELIA - EUROPEAN LEAGUE OF INSTITUTES OF THE ARTS

FALEMNDERIT!

WWW.MITROVICAGREENFEST.COM

FACEBOOK: GREENFEST

INSTAGRAM: GREENFEST14